



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË

Dt.21.10.2022 Nr. 476/22

Në mbështetje të nenit 8, paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 5, pika c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 ,nenit 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe në bazë të Vendimit të Kuvendit Komunal të Komunës së Fushe Kosovës me numër 05.07.2022 me numër 170 për lejimin e mjeteve financiare për punëtorë arsimor, bazuar në Qarkoren Buxhetore të MFPT të datës 13.05.2022 me numër 996/22 faqe 16, dhe vendimit me numër 735 të datës 19.08.2022 Drejtoria për Arsim shpallë:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të punës për kohë të caktuar viti shkollor 2022/23 me mundësi vazhdimi .

Nr.	Niveli	Pozita	Vend i lirë	Numri i Pozitave
2.	SHFMU “ Mihal Grameno”	Mësimdhënës/e për Histori	Vend i lirë	1

I. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet, si vijon:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në Komunë, në Arkiv ose në web. të Komunës),
- Rezymeja personale (CV),
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë),
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara të Noterit dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasysh,
- Certifikata që nuk jeni nën hetime,
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit para universitar, Ligjit Nr.02/L-52, Ligjit Nr.03/L-068 dhe Ligjit Nr.04/L-138, si dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT-it (UA Nr.05/2021) dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

RE
OBY
DIA

- Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**

- VËREJTJE:** Sipas Udhëzimit administrativ (MASHTI) NR.05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, neni 7 paragrafi 25, “Të gjithë kandidatët e kualifikuar në nivelin arsimor 300 ECTS për disiplinat nga paragrafi 1-24 të këtij neni, në fakultetet tjera përveç Fakultetit të Edukimit, të cilët i kanë filluar studimet para hyrjes në fuqi të UA nr.06/2015 të datës

10.07.2015, i plotësojnë kriteret për punësim”. neni 11 paragrafi 3, “Të gjithë të kualifikuarit në njësitë akademike që kanë përfunduar master arsimor 300 ECTS, kanë të drejtë të barabartë konkurrimi në arsimin para universitar të paraparë në nenin 6 dhe 7 të këtij Udhëzimit administrativ”.

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar, sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen. Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheqë 100 pikë apo deri në 50% të vlerësimit përfundimtar.

Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim i nënshtrohen intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri 100 pikë apo 50% e vlerësimit përfundimtar

Vlerësimi në intervistimin me gojë bazohet në këto kriterë:

Njohuritë e përgjithshme - 25 pikë,

Aftësitë e përgjithshme dhe të personalitetit - 35 pikë, dhe

Njohuritë profesionale - 40 pikë (ku përfshihen përvoja e punës dhe kualifikimi profesional gjatë studimeve). Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidati me më shumë pikë do të përzgjidhet në pozitën e lartcekur.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata të cilat janë të dëshmuara me dokumente dhe jo ato që janë të deklaruara pa dëshmi.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës, diplomat duhet t'i kenë të nostifikuara nga MASH-i.

Për intervistë do të ftohen ata kandidatë që i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test, intervistë si dhe orari i intervistës do të publikohen në web faqen e Komunës së Fushë-Kosovës.

<https://kk.rks-gov.net/fushekosove/>

Me këtë konkurs zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor 2022/2023. Në rast të ndonjë nevojë eventuale për mësimdhënës/e në IEM, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listës së publikuar me rastin e shpalljes së rezultateve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e

informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më **24.10.2022** deri më **07.11.2022**.

Aplikacioni i kompletuar me të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohet në

Komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Arkivit në objektin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Vërejtje: Pas aplikimit kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit e cila është e domosdoshme për fazat e tjera të proceduarave të konkursit.

Adresa: Objekti i Komunës, rruga Tahir Zemaj nr.2, Fushë-Kosovë.

Drejtoria për Arsim
Fadil Krasniqi

